



Znj. Elsa Dhuli u emërua Drejtore e Përgjithshme e Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në Nëntor 2020, më parë ajo ishte drejtore e përgjithshme e komanduar për më shumë se një vit. Mban gradën Doktor në Statistika, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Më parë, ajo ka mbajtur pozicionin Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor dhe para kësaj Koordinatore e Cilësisë Statistike, Drejtore e Statistikave Ekonomike, Përgjegjëse e Statistikave Afatshkurtra, Specialist pranë Statistikave të Ndërmarrjeve.

Në fushën profesionale, Znj. Elsa Dhuli ka kontribuar prej 30 vitesh në fushën e statistikave, kryesisht ekonomike, në zbatimin e standarteve evropiane dhe ndërkombëtare për zhvillimin e statistikave në vend dhe përmirësimin cilësor të tyre. Në fushën profesionale aktivitete të tjera lidhen me kontributin në zbatimin e Klasifikimeve dhe Nomenklaturave në vend, ka drejtuar Rregjistrimin e Ndërmarrjeve Ekonomike në vitin 2010, ka dhënë kontributin e saj në hartimin e disa Programeve Statistike Zyrtare, Strategjisë së zhvillimit të INSTAT dhe Sistemit Kombëtar Statistikor. Si Koordinatore e Cilësisë ajo ka kontribuar në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare për Menaxhimin e Proceseve Statistike, Udhëzuesin e Cilësisë, Aksesin mbi Politikën e Mikrodateve dhe Kornizën e Vlerësimit të Performancës institucionale.

Krahas cilësimeve të mësipërme, Znj. Dhuli ka zhvilluar kapacitetet në fushën e statistikave dhe leadership nga pjesëmarrja e saj në trajnime afatgjata dhe afatshkurtra, seminare dhe grupe pune të ndryshme, apo nga bashkëpunimet institucionale me partner ndërkombëtarë.

Aktualisht është Kryetare e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave; Anëtare e Këshillit të Statistikave; Negociatore për Kapitullin 18 "Statistikat" për pranimin e Shqipërisë në BE. Në arenën ndërkombëtare, është koordinatore e vendit për platformën e-GDDS (NSDP-FMN); Strategjinë për Evropën Juglindore, SEE 2030; anëtare dhe bashkëdrejtuese e Grupit të Nivelit të Lartë për Bashkëpunim, Partneritet dhe Zhvillim Kapacitete në Kombet e Bashkuara në Divizionin e Statistikave (UNSD-HLG-PCCB) dhe anëtare e Ethical Leadership Task Team (UNECE- Grupi i Nivelit të Lartë për Modernizimin e Statistikave Zyrtare). Gjithashtu është e angazhuar në mësim dhënie pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Masteri Shkencor i Statistikave Zyrtare.